



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA GJIROKASTËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**  
NR 37, DATË 01/06/2026

**“PËR PËRCAKTIMIN E ELEMETËVE TË PAGËS BRUTO PËR STRUKTURËN E POLICISË BASHKIAKE GJIROKASTËR”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 01.06.2026 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për përcaktimin e elemetëve të pagës bruto për strukturën e Policisë Bashkiake Gjirokastrë”. Mbështetur në nenin 54, shkronja k, neni 64, e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjin nr 35/2023 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, VKM-në nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekte page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ndryshuar, Vendimin nr. 452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, Udhëzimin nr 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, VKB-në nr.101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” i ndryshuar, VKB-në nr. 23, datë 30.03.2026 “Për një ndryshim të pikës 2, të VKB-së nr. 92, datë 22.12.2025 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2026”.

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë elementët e pagës bruto mujore për strukturën e Policisë Bashkiake me përbërje:
  - a) Paga bazë për klasë, sipas VKB-së nr. 23, datë 30.03.2026 “Për një ndryshim të pikës 2, të VKB-së nr. 92, datë 22.12.2025 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2026”,
  - b) Shtesa për vjetësi në punë, të jepet në masën 1 (një) përqind të pagës bazë për klasë.
2. Burimi i financimit të jetë buxheti i vitit 2026.
3. Efektet financiare të fillojnë nga data 01 Janar 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Bexhet Baxhella

KRYETARI I KËSHILLIT  
Merita Isaraj